



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 570/2 Prot.

Tiranë, më 11.05 2019

**Lënda:** Njoftim Publik

**Për ZNJ. MARTA KOZMA MALE**

Me adresë të njohur: Rruga e Dibrës, Tiranë

Me shkresën nr.738/2 prot., datë 25.02.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i Deputetit, z.Ervin Bujar Salianji, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Korçë, propozuar nga subjekti politik, Partia Demokratike.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i Deputetit, është kandidati me numër rendor 11, znj.Marta Kozma Male.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumemërore për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidati i listës shumemërore të Partisë Demokratike, znj.Marta Kozma Male, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Me shkresën nr. 570 prot. datë 27.02.2019, kandidates i është dërguar në adresën e njohur, si më sipër, njoftimi për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit. Nga njoftimi i postës i kthyer në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rezulton se ky njoftim nuk i është dorëzuar për arsye se adresa e dhënë prej saj në dokumentacionin e kandidimit është e pasaktë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidates nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e saj. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me afishimin e kësaj shpallje, kandidatja vihet në dijeni për njoftimin e saj për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Afati i dorëzimit fillon nga data e publikimit të kësaj shpallje.



Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall faktin e moszgjedhshmërisë.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me Kreun II, pika 7, dhe Kreun III pika 2, e Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".